



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIK - KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-GPS TINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	<u>73/16</u>
Nr. i fq. / Br. st	<u>- 11 -</u>
Data: / Datum	<u>28. 04. 2016</u>
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNĒS-VUSHTBRI

PROCES VERBAL
NGA MBLEDHJA E III-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 31 MARS 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10.10

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Ne kete mëdrije ishm te përmeshtet e Kuvendit te Komunës në Vushtrri:
Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrovë, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –në kuadër të diskutimeve lidhur me rendin e ditës paraqiti një pikë shtesë për futje në rend të ditës propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për Besarta Verbofcin nxënëse në kolegjin “Mehmet Akif” e cila do të marr pjesë në një garë ndërkombëtare.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit-propozoi që pikë e tetë të hiqet nga rendi i ditës më qëllim që këtij propozim-vendimi ti bashkëngjiten kriteret e nevojshme lidhur me të drejtën që zyrtaret e administratës komunale a kanë të drejt të jenë pjesë e këtyre trupave si dhe propozoi që për këtë çështje të formohet edhe komisioni për zhvillimin e procedurave për anëtarësim në këto komitete.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –sqaroi se komiteteve konsultative iu ka kaluar mandati dhe shtoi se çështja se a kanë drejt drejtë që zyrtaret komunal të jenë pjesë e këtyre trupave është e përcaktuar me ligj ku atyre ju ndalohet të jenë pjesë e tyre, kurse lidhur me formimin e komisionit për përgjedhjen e anëtareve të këtyre komiteteve do të merret vendimi brenda kësaj pike të rendit të ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
 2. Shqyrtimi i Raportit të Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe realizimin e investimeve kapitale për vitin 2015;
 3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Dekorata (**shqyrtimi i parë**);

4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për menaxhimin e parkingjeve publike (**shqyrtimi i dytë**);
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira) financiare nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016;
6. Shqyrtimi i Informatës mbi ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në komitetet konsultative.
9. Shqyrtimi i Petpcionit të banorëve të zonës së qytetit në rrugët: “Hakif Zejnullahu” “Haxhi Zeka”, “Avni Rrustemi”, “Vellezërit Frashëri”, “Shemsi Ahmeti”, “Shaban Kapuç” dhe “Ganimete Tërbeshi” në Vushtrri.
10. Të ndryshme.
 - a. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione për Besarta Verbovcin.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për klubin e futbollit “Vushtrria”.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Raportit të Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe realizimin e investimeve kapitale për vitin 2015;

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se raporti për situatën ekonomiko-financiare për vitin 2015 i parashtruar nga ana e ekzekutivit komunal është gjithëpërfshirës. Tutje shtoi se krahasuar me vitin 2014 kemi kursimi dhe ulje të shpenzimeve dhe në të njëjtën kohë ngritje të përgjegjësisë në menaxhimin e parasë publike. Mirëpo vlerësoi se dukuria e nivelit të ulët të ikasimit të të hyrave vetanake po vazhdon akoma me një përqindje prej 84% dhe apeloi që të rritet angazhimi maksimal në rritje e këtë burimi të të hyrave komunale. Pastaj ceku se në raport janë shpërfaqur të gjitha aktivitetet e prokurimit (kontratat) dhe kjo është pozitive por ceku se duhet të përqendrojmë vëmendjen tek kualitetit i punëve dhe projekteve të cilat janë duke u përfunduar në komunën tonë, dhe për këtë pyeti se këto punime sa janë duke u përcjell nga komisionet përkatëse dhe nga zyra e prokurimit dhe në këtë kontekst a kemi si thuhet “listën e zezë” të ndërmarrjeve të cilat janë të papërgjegjshme në kryerjen e punimeve. Mandej vlerësoi në mënyrë pozitive uljen e shpenzimeve për karburantet me vitin paraprak e që kemi një zbritje prej 20.000€. Lidhur me shpenzimet e ujit dhe rrymës tha se kemi shpenzime të larta por edhe këtu duhet të bëhen përpjekje që këtë shpenzime të zvogëlohen. Tutje potencoii se çështje e menaxhimit të pronës kërkon një menaxhim tjetër fare dhe atë më cilësor dhe me ma përgjegjësi përfaktin se në komunën tonë është duke vazhduar regjistrimi i pronës komunale në këtë kontekst vlerësoi se tek një kategori e caktuar e pronës komunale të dhëna në shfrytëzim kemi të hyra por tek prona bujqësore është një gjendje jo e mirë dhe për këtë çështje nuk kemi shënimë dhe informata të sakta. Pastaj vlerësoi se tek Drejtoria e Kadastrit nuk kemi një specifikim të saktë se sa kemi uzurpime dhe shpronësime të pronës komunale, dhe për këtë çështje kuvendi nuk ka asnjë informatë. Në vazhdim ai duke ju referuar gjithnjë raportit në fjalë vlerësoi se borxhet e këqija të pa inkasuara që dikur ishin 2.000.000€ tanë kuvendi nuk është i informuar se sa është vlera e këtyre borxheve. Në fund ai kërkoi informatë me shkrim lidhur me pronat bujqësore të dhëna në shfrytëzim, emrat e përfituesve të këtyre pronave të marra në shfrytëzim, mjetet e inkasuara nga këto qira, padit për kompensimin e dëmeve lidhur me këto

prona për shkak të mos pagesës së detyrimeve nga shfrytëzuesit e këtyre pronave si dhe çështje tjera të cilat kanë mundur të iniciohen dhe ndiqen gjyqësisht nëpër gjykata lidhur me këto prona.

Fatime Haziri, anëtar i kuvendit-tha se raporti për situatën ekonomiko-financiare të komunës është gjithëpërfshirës dhe në emër të grupit kuvendar të LDK-së paraqiti disa vërejtje për shumat e mjeteve të shpenzuara për mallra dhe shërbime që figurojnë në tabelën faqe 5, më konkretisht tek kodi me numër 13320 faqe 5 shpenzimet e telefonisë mobile krahasuar me vitin 2014 shpenzimet gati sa janë dyfishuar dhe për këtë kërkoi sqarim. Pastaj tek shërbimet e arsimit dhe trajnimit në vitin 2014 nuk ka pasur fare shpenzime kurse në vitin 2015 ka qenë një shumë prej 6380 €, pastaj tek shërbimet teknike në vitin 2014 gjithashtu nuk ka pasur shpenzime kurse në vitin 2015 janë shpenzuar 5258 € mandej, tek kodi 15303 pozicioni kompjuter me më pakë se 1.000€ është trefishuar që vitin 2014 shpenzimet kanë qenë 4650.90€ kurse gjatë vitit 2015 shpenzimet janë në vlerën prej 11,739€. Pastaj tek mirëmbajtja rutinore në vitin 2014 nuk kemi shpenzime kurse në vitin 2015 shpenzimet janë në vlerë prej 52,800.10€. Mandej tek Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi vlerësoi se kishte me qenë mirë që në raport të përfshihen dhe raportohen disa problem të cilat janë shfaqur tek subvencionimi me bletë pasta me lopë pastaj mjedrat. Gjithashtu tek Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit cekën mbështetësit që kanë ndihmuar në revidimin e Planit Zhvillimor Komunal por nuk figuron kompania që merret me këtë revidim të këtij plani si dhe afati i përfundimit të këtij procesi. Në fushën e planifikimit urban nuk ka njoftim për planet rregulluese se sa është mbuluar qytetit me plane rregulluese apo me plane zonale, kurse për lejet ndërtimore kishte me qenë mirë të raportohet për problemet apo shkaqet që kanë ndikuar në numrin e vogël të lëshimit të këtyre lejeve sepse kjo reflekton edhe në buxhetin komunal.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-duke ju referuar raportit në fjalë pyeti, se a ka marr përgjegjësi ndonjë subjekt për problemet që janë shkaktuar gjatë ndarjes së subvencioneve. Tutje shtoi se kompanitë e kontraktuara përfurnizim me lopë dhe bletë duhet të bëhen publike para anëtarëve të kuvendit si dhe të njëjtat duhet të ngarkohen me përgjegjësi për veprimet e tyre, të cilat kanë ndikuar në dëmtimin e buxhetit të komunës por edhe prishjen e imazhit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se si qeveri komunale vazhdimisht janë angazhuar që të jenë transparent në menaxhimin e parasë publike dhe udhëheqjen komunale në përgjithësi. Tutje duke ju referuar raportit njoftoi se janë realizuar 190 projekte kapitale në vlerë financiare prej: 8,737.223 €, ku komuna ka participuar me shumën prej 6,397.569 €, participimi i komunitetit ka qenë në vlerë prej 86,360.30 € kurse qeveria qendrore ka kontribuar me mjete financiare në vlerë prej: 1,804.837.25 € kurse donacione kanë qenë 448,456.16 €. Pastaj lidhur me shpenzimin e këtyre parave arsyetoj se është munduar maksimalisht që këto para të shkojnë në realizimin e atyre projekteve të cilat kanë qenë të nevojshme dhe të cilat e kanë përmirësuar jetën e qytetarëve tanë. Mandej ai potencoi se gjatë punës së tyre sidomos në Drejtorin e Prokurimit është respektuar ligji i prokurimit dhe se mjetet e planikuara që kanë qenë të dedikuara përfundimin e projekteve janë kursyer duke u zbatuar ligji dhe në këtë formë rreth 1,300.000 € kanë tepruar prej atyre të planikuara në investime kapitale dhe këto mjete kanë kaluar në projekte të reja ose në plotësimin e atyre projekteve të mbeturës së gjysmë, ose janë bartur përtu realizuar këtë vit. Në vazhdimi ai vlerësoi se deficiti i realizimit në masën prej 87% të të hyrave vetanake është mbuluar nga teprica e këtyre mjeteve, nga projektet tjera. Tutje ai duke ju referuar çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit paraqiti përgjigje në pyetjet e tyre duke shtuar se të hyrat vetanake janë plotësuar me tri burime kryesore të të hyrave komunale tatimi në pronë, taksa në firmë dhe të hyrat nga lejet ndërtimore kurse angazhimi i qeveris në arkëtimin e të hyrave komunale ka qenë kryesisht në kategorinë e tatimit në pronë por edhe këtu kemi miliona borxhe të këqija të cilat po kemi vështirësi në mbledhjen e tyre kurse ligji përfaljen e këtyre borxheve vetëm sa i ka komplikuar gjërat. Pastaj lidhur me faktin se numri i lejeve ndërtimore është i vogël ceku se ky numër nuk është i vogël dhe se sikur vitin e kaluar asnjëherë nuk kemi pasur zhvillimi të ndërtimeve në komunën tonë dhe për këtë kemi

tejkalim të mjeteve të planifikuara në Drejtorin e Urbanizmit. Mandej lidhur me kualitetin e punimeve ceku se janë komisionet kompetente të cilat merren me mbikëqyrjen e këtyre punimeve dhe vlerësoi se jo gjithherë është i kënaqur me zhvillimin dhe kualitetin e këtyre punëve, dhe njoftoi se ka operator ekonomik të cilët janë të penalizuar dhe të ndjekur edhe gjyqësishtë andaj për këtë kemi edhe konteste gjyqësore të cilat komuna i ka fituar dhe tani pritet edhe ekzekutimi i atyre lëndëve tek përmbaruesi privat, kurse për disa operator ekonomik është marr vendim që mos mund të marrin punë nga komuna për shkak të kualitetit të dobët të punëve të kryera nga ana e tyre. Tute lidhur me shpenzimet e karburanteve njoftoi se komuna ka kontrata me disa kompani siç janë "Uniteti" dhe "Iber Lepenci" për pastrimin e deponive të mbeturinave dhe për pastrimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve të prrockave dhe lumenjve me ç' rast kemi komuna merr obligimin për mbulimin e shpenzimeve të karburantit dhe kjo ka bërë që të ngritën shpenzimet për derivate. Mandej tek menaxhimi i pronës publike tha se ka mundësi që akoma më shumë të bëhet një menaxhim më i mirë por njoftoi se për të gjithë ata qiramarrës të cilët nuk i kanë kryer obligimet do tu shkëputen kontratat dhe do të ballafaqohen me padi nëpër gjykata. Pastaj lidhur me shpenzimet e telefonisë mobile tha se e ka vërejtur që ka ngritje të shpenzimeve dhe njoftoi se është bërë një marrëveshje me valën për komunikim pa pagesë mesë zyrtarëve komunal dhe zyrtarëve tjera me kushte mjaf të volitshme kurse telefonat fiks me një vendim janë ndërpre nga funksioni me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve. Tute lidhur me subvencionimin me bletë dhe lopë njofto se fatkeqësisht ka pasur probleme me realizimin e këtyre projekteve dhe njëri nga këto projekte ai me furnizim me bletë ka dështuar. Në këtë kontekst ai shtroj çështjen e dëmeve ku vlerësoi se në këtë proces janë dëmtuar më së tepërti fermerët të cilët nuk mundën ti marrin këto subvencione, por edhe kompania e cila është marrë me furnizim me bletë. Kurse lidhur me projektin për furnizim me lopë nuk ka asnjë problem dhe se është alarmuar pa bazë dhe pa nevojë për faktin se ky projekt është realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Në fund tha se lidhur me projektin për furnizim me mjedra projekt i cili ka qenë në bashkëpunim me IADKN janë paraqitur ankesa nga dy përfituese për gjoja se mjedrat kanë qenë të sëmura dhe nëse kjo gjë vërtetohet ata mundën të ushtrojnë padi në gjykatë kundër IADKS si realizuese e këtij projekti.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se është e aftësi e menaxhmentit komunal që në dy projektet e sipër cekura ka arritur të mbroj buxhetin e komunës nga dëmet eventuale dhe ripërserit që kompanitë kontraktuese për furnizim me bletë dhe lopë duhet të ndëshkohen për dështimet e tyre profesionale dhe për papërgjegjësi në kryerjen e detyrate të tyre.

Fadil Muzaqi, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit-paraqiti sqarime lidhur me projektet në fjalë duke shtuar se sa i përket aktivitetit të prokurimit furnizim me bletë për fermer ka rezultuar si i pasuksesshëm jo nga ana e komunës por nga ane e operatorit ekonomik. Tute shtoi se operatori ekonomik i ka sjell bletë nga importi nga Maqedonia dhe këto bletë kanë rezultuar të sëmura ku fillimisht janë pranuar nga AVUK-u ku në bazë të raportit të tyre ka qenë çdo gjë në rregull si dhe para shpërndarjes ky autoritet ka lëshuar një proces ku konstaton se gjithçka ishte në rregull mirëpo, pasi që fermerët i kanë marrë bletë është thënë se është shfaqur një sëmundje me ç' rast kjo na ka obliguar që këto bletë të asgjësohen. Në fund tha se autoritetet komunale i kanë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme të domosdoshme duke zbatuar kontratën në përpikëri dhe duke anuluar aktivitetin e prokurimit.

3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Dekorata (shqyrtimi i parë);

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Dekorata.

2. Diskutimi publik fillon nga data 04 prill 2016 dhe zgjatë deri më 22 prill 2016.

3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4.Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DKRS -ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin prill 2016.

4.Shqyrtimi i Draft Rregullores për menaxhimin e parkingjeve publike (shqyrtimi i dytë);

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-propozoi që në nenin 21 paragrafi 2 të bëhet zëvendësimi i fjalës “sigurojë” me fjalën *përkujdesëm* nga ana e shfrytëzuesve të parkingjeve publike në rastet e vjedhjeve apo shkaktimit të dëmit eventual të automjeteve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 30 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Menaxhimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Vushtrrisë.

5.Shqyrtimi i Propozim Vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira) financiare nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016;

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime hyrës lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se pas gjenerimit të raportit del se kemi ngritje të buxhetit dhe me kërkesë të Ministrisë së Financave kemi qenë të obliguar që serish ta sjellim për votim këtë propozim-vendim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim barten mjetet e lira të mbeturë nga viti 2015 në vitin 2016 në shumën prej 459, 300.09 € në kategoritë ekonomike si në vijim:

1.1 Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111) në shumën prej 9, 201.00 €;

1.2 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë mallra dhe shërbime (kodi 130) në shumën prej 53,867.34 €;

1.3 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzimet komunale (kodi 132) në shumën prej 1,507.83 €;

1.4 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë subvencione dhe transfere (kodi 200) në shumën prej 10,803.01 €;

1.5 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzime kapitale (kodi 300) në shumën prej 383,920.91 €

1.6 Shuma e mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016 është gjithsejtë 459, 300.09 €.

2.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat 4.1 dhe 4.2.

3. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01.Nr.33/16 i datës 25.02.2016 me të cilin është bërë bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016.

6.Shqyrtimi i Informatës për ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë;

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se informata në fjalë paraqet gjendjen çfarë e kemi në komunën tonë e që fatkeqësish nuk është e mirë kur bëhet fjalë për ndërtimet. Tutoj shtoi se një dukuri e caktuar të cilës nuk i jepet sanksioni i duhur në tersin e saj nuk mund të kemi rezultatet dhe efekt pozitive për ti luftuar dukurit negative të ndërtimeve në kundërshtim me rregullat dhe standarde të ndërtimit. Pastaj shprehu se në informatë figurojnë konstatimet dhe procesverbala të konsoliduara e gjendjes faktike të ndërtimeve por si duket mungon implementimi i vendimeve lidhur me rrënimin e ndërtimeve. Mandjej gjendjen e bënë akoma më të rënduar tërheqja e kompanisë e cila ka qenë përgjegjëse për rrënimin e ndërtimeve pa leje apo ndërtimeve të kundërligjshme dhe këtu tanë mund të dalin opiniione prej më të ndryshmeve për faktin se ka vend për spekulime dhe dëmtimi të imazhit të komunës. Në këtë kontekst komuna duhet sa më parë të bëjë të mundur kontraktimin e një kompanie të përgjegjshme për ekzekutimin e vendimeve të Drejtorisë së Inspektiveve dhe organeve tjera. Pastaj vlerësoi se duhet të jemi konsistent në përcjelljen e punimeve ndërtimore sipas lejes ndërtimore dhe kriterieve të ndërtimit në përmasa, dimensione dhe etazhe të ndërtimit se këto standarde ai i përgjigjen vërtet lejes së ndërtimit. Në fund tha se duhet të shikohet se sa prej këtyre objekteve kolektiv kanë lejen e shfrytëzimit dhe përdorimit si dhe apeloi që komuna sa më ë parë të kontraktoj një kompani për rrënimin e objekteve pa leje.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit –pyeti se a po respektohet ligji për ndërtim lidhur me hapësirat gjelbëruese, parkingjet për automjete si dhe hapësirat përfshirë gjatë procesit të dhënies së lejeve ndërtimore.

Gëzim Saraqi, drejtor i DI-së-paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Pastaj ai vlerësoi se pajtohet me konstatimin se gjendja e ndërtimit në komunën tonë nuk është e mirë dhe përkthetë se ka ndikuar dhe po vazhdon të ndikoj mungesa e një operatori ekonomik që merret me rrënimin e objekteve pa leje. Tutoj shtoi se Drejtoria e Inspektiveve ka vepruar me kohë dhe ka udhëhequr të gjitha procedurat ligjore për kontraktimin e një kompanie e cila merret me këtë çështje. Lidhur me ndërtimet gjatë vitit 2015 njoftoi se ka pasur dy raste ku nuk janë respektuar normat ligjore të ndërtimit ku në njërin rast vetë rrënimi është bërë nga vet ndërtuesi kurse në rastin tjetër rrënimi është bërë nga kompania që në atë kohë ishte e kontraktuar.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit –pyeti drejtorin e Drejtorisë së Inspektiveve se sa ndërtime pa leje janë në komunën tonë, dhe i rekomandoi atij që vendimet për rrënimin e ndërtimeve pa leje të mos i evidentoj fare në informatë përfshirë faktin se ato asnjëherë nuk janë duke u ekzekutuar pasi që siç tha ai prapa këtyre pengesave qëndron politika.

Gëzim Saraqi, drejtor i DI-së-në përgjigje ndaj anëtarit të kuvendit Rrahim Ajeti tha se drejtoria mund të rrënoj objekte pa leje vetëm atëherë kur ekziston mekanizmi në këtë rast kompania përgjegjëse përfshirë rrënimin e objekteve pa leje.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit –tha se objekti për të cilin është bërë fjalë në media është rrënuar nga vet ndërtuesi në marrëveshje me komunën.

Gëzim Saraqi, drejtor i DI-së–tha se objektin se sipër apostrofuar e ka rrënuar kompania “Doni Komerc ” pas autorizimit nga ana e Drejtorisë së Inspektiveve.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;

8. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në komitetet konsultative;

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi që në kuadër të këtij konkursi të formohet edhe një komitetit i veçantë Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta si dhe propozoi që paneli për përzgjedhjen e anëtarëve të Komiteteve Konsultative të jetë prej pesë anëtarëve dhe atë 2 nga PDK, 1 nga LDK, 1 nga LVV, dhe 1 nga shoqëria civile.

Në vazhdimi kuvendi me 23 vota “për” tjerat abstenim aprovoi çelësin për formimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-propozoi Habib Mustafen për anëtar të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – propozoi Habibe Gérxhaliu për anëtare të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – propozoi Shkelzen Feken për anëtar të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Myrvete Hetemin për anëtare të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-propozoi Isak Hysenin nga shoqëria civile si anëtar të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative.

Pas paraqitjes së propozimeve për anëtar të panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative kuvendi me 29 vota “për” tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet paneli përzgjedhës për anëtarësim në komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 **Habib Mustafa, anëtar i kuvendit (PDK);**
- 1.2 **Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit (PDK);**
- 1.3 **Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit (LDK);**
- 1.4 **Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit (LVV);**
- 1.5 **Isak Hyseni, nga shoqëria civile.**

2. Paneli përzgjedhës i cekur në pikën 1 të këtij vendim do të ketë për obligim intervistik dhe përzgjedhjen e kandidatëve si dhe do ti propozoi kuvendit listën me kandidat për anëtarësim në komitetet konsultative.

3. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: paneli i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e Kuvendit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota “për” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në këto komitetet konsultative të KK-së:

- 1.1 Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);**
- 1.2 Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtar);**
- 1.3 Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e ambientit (7 anëtar);**
- 1.4 Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);**
- 1.5 Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);**
- 1.6 Komiteti për Personat me Nevoja të Veçanta (7 anëtarë).**

2. Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenet 4.1, 4.3 dhe 4.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/10.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Petpcionit të banorëve të zonës së qytetit në rrugët: "Hakif Zejnallahu" "Haxhi Zeka", "Avni Rrustemi", "Vëllezërit Frashëri", "Shemsi Ahmeti", "Shaban Kapuç'i" dhe "Ganimete Tërbeshi" në Vushtrri.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se këtë peticion kuvendi e ka për obligim ta shqyrtoi si çdo peticion tjetër dhe vlerësoi se frustimi momental i këtyre qytetarëve ka bërë që këta ta parashtrojnë këtë peticion. Tutje shtoi se zhvillimi i qytetit nuk duhet të pengohet me petacione të tilla por se duhet të zbatohet ligji dhe standartet dhe kriteret tjera të ndërtimit. Pastaj ceku se çdo qytetar ka të drejt të posedoj me pronën e tij ashtu se si e sheh ai se përfton më së miri. Në këtë kontekst theksoi se në rast se ne do të përkrahnim një peticion të tillë atëherë do të cenonim të drejtë elementare të disponimit të pronës. Në vazhdim ai ceku se kuvend duhet ti jap përkrahje të fuqishme Drejtorisë së Urbanizimit që konform ligjit dhe rregullave në fuqi të veproj në bazë të kërkesave të qytetarëve për ndërtimet.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se e kundërshton fjalimin e para folësit të tij duke shtuar se banoret e këtyre lagjeve parashtrues të këtij peticioni plotësisht kanë të drejt, përfaktin se këto kompanitë lokale të ndërtimit kanë një strategji shumë perfide duke i marrë nga 10 ari tokë dhe kjo bëhet me plan dhe kështu e bëjnë të pa mundur banimin rrëth këtyre pronave ku ndërtohet. Tutje shtoi se këto firma e kanë bërë një të ashtuquajtur "oborr mbretëror" dhe kështu në bazë të planeve të tyre ndikojnë për ti "paralizuar lagjet e caktuara". Në fund ai apeloi që të mos përkrahen firmat "monopoliste" të ndërtimit të cilat po ndikojnë keq në lagjet e caktuara.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se para folësi i tij z. Ali Jonuzi lëshohet në gjëra të cilat nuk kanë të bëjnë me ligjin kurse ai është për zbatimin e ligjit. Tutje sqaroi se për rastin në fjalë ka pasur kërkesë për ndërtim të lartë, dhe e njëjta në mënyrë kundërligjore i është refuzuar firmës ndërtuese dhe në bazë të ankesës çështja është proceduar në shqyrtim në ministrin gjegjëse dhe sipas të gjitha gjasave e njëjta çështje do ti kthehet komunës në rishqyrtim. Lidhur me konstatimet përfaktin se kompani monopoliste tha se një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm përfaktin se komuna jonë nuk ka kompani të tillë sepse shkalla e zhvillimit ekonomik i dikton format e ndërmarrjeve të tillë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se dihet fakti se komuna aktualisht është duke punuar në revidimin e planit zhvillimor komunal dhe pyeti se konform planit a lejohen ndërtimet e larta në atë pjesë të qytetit dhe pastaj të merremi me këtë peticion andaj lidhur me këtë çështje kërkoi që respektohet ligji.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –propozoi që me banoret e këtyre lagjeve parashtrues të petpcionit të ketë biseda dhe atë në suaza të ligjit. Tutje shtoi se në kuadër të revidimit të

planit zhvillimor komunal këto çështje duhet të adresohen dhe tu jepet përgjigje e duhur si për nga hapësirat e zonave ndërtimore ashtu edhe për etazhet e ndërtimeve por edhe për kriteret tjera ndërtimore. Në fund ai tha se duhet të zbatohet ligji lidhur me të gjitha çështjet e ndërtimeve dhe bëri apel që me këta qytetar të kemi një komunikim më të drejtpërdrejtë me qëllim të gjetje së një zgjidhje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se me petizione nuk mund të ndalohet zhvillimi i qytetit, dhe vlerësoi se është pikërisht kuvendi i komunës që pra disa mandateve ka miratuar planin zhvillimor komunal dhe planin urban të cilat jemi të obliguar ti zbatojmë të gjithë. Tutje shtoi se konform këtyre dokumenteve komunale lejohet ndërtimi i lartë në atë pjesë të qytetit dhe se refuzimi i kërkesës ndaj këtij investitorit është bërë në mënyrë kundërligjore për të cilën shpreson se ministria gjegjëse do ta kthej serish në rishqyrtim në organet komunale. Në fund tha se vlerësimi se janë bërë kompani monopoliste është i pa qëndrueshëm dhe shtoi se nuk është në dijeni se në komunën tonë ka ndërmarrje përfide.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës–tha se si rezultat i bërjes së shpejt të ligjeve pa u analizuar gjendje mire në teren po kemi shumë gabime në miratimin e këtyre ligjeve. Tutje ai parashtroj disa shembuj se si komuna ka pasur shumë problem si rezultat i këtyre ligjeve duke apostrofuar gjendjen me ndërmarrjen “stacioni i autobusëve”. Pastaj ai theksoi se në zonën ku është refuzuar kërkesa për ndërtim të lartë ajo zonë nuk është e rregulluar me planë rregullativ po ekziston vetëm planin zhvillimor urban dhe sipas këtij plani po del se ndërtimet e larta në atë zonë lejohen. Tutje si rezultat i ankesave të qytetarëve është refuzuar kërkesa për leje ndërtimore në këtë zonë dhe ndoshta kjo është bërë me të drejt përfaktin se nuk mund të lejohet ndërtimi në mes të lagjes. Në të kundërt nëse komunititetit i cili banon në këtë zonë nëse do të merren vesh që për një periudhë të caktuar të lejohen ndërtimet e larta atëherë çdo gjë do të ishte në rregull andaj këto çështje duhet të rregullohen me planë rregullativ. Në fund ai tha se duhet të kemi shumë kujdes sidomos niveli qendror gjatë fazës së nxjerrjes së ligjeve dhe në këtë proces duhet të involvohen edhe qytetarët.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 22 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 31 mars 2016, pas shqyrtimit të petcionit të banorëve të zonës së qytetit në rrugët: “Hakif Zejnullahu” “Haxhi Zeka”, “Avni Rrustemi”, “Vëllezërit Frashëri”, “Shemsi Ahmeti”, “Shaban Kapuçii” dhe “Ganimete Tërbeshi” në Vushtrri ndaj Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit parashtron këtë:

Kërkesë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që në rastin e vendosjes për dhënien e lejeve ndërtimore në këtë zonë të bazohet në suazat ligjore të Ligjit për Ndërtim, Planit Zhvillimor Komunal dhe në aktet tjera të nxjerra nga kuvendi i komunës dhe nga niveli qendrorë.

Gjithashtu kuvendi kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm që banoret e kësaj zone parashtrues të petcionit të njoftohen me shkrim për shqyrtimin e petcionit nga ana e kuvendit të komunës si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e Drejtorisë lidhur me çështje në fjalë.

10.Të ndryshme.

a).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione për Besarta Verbovcin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim i ndahen mjete financiare Besarta Vérbovcit nxënëse në Kolegjin “Mehmet Akif”, në shumë prej njëmijë e pesëqind euro (1.500 €), e cila do të merr pjesë në Olimpiadën Ndërkombëtare “ International Project Olympiad” e cila do të mbahet prej datës 27 prill deri me 03 maj 2016 në Nairobi, Kenia.

2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere, dhe kjo shumë ndahet në emër të Melihate Vérbovcit nëna e të lartcekurës, për shkak se e njëjtë është e moshës së mitur.

3. Nxënësja Besarta Vérbovcit pas kthimit nga gara në Keni, obligohet që t'i ofroj dëshmitë e pjesëmarrjes në Olimpiadën e lartcekur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

c). Pyetet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës se a ka mundësi që të ndihmohet klub i futbollit “Vushtria” pasi që ky klub gjendet në një fazë të kritikës dhe kështu këtij klubu do ti mundësohej që ti zhvilloj ndeshjet e mbeturës së gjysmë dhe që eventualisht ky klub të mbetet në ligë. Pastaj pyeti se pas dorëheqjes së kryetarit të klubit në kompetencë të kujt është që të thirret kuvendi i ri i klubit që eventualisht ky klub të kthehet në pronësi të komunës.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-pyeti kryetarin e komunës se përsë nuk po zbatohet vendimi i kuvendit lidhur me pagesën e komisionit për emërtimin e rrugëve.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit-kërkoi informatë me shkrin se në cilat pjesë të qytetit janë të parapara për ndërtimë të larta dhe deri në sa kate si dhe ndërtuesat e ndërtuarës deri me tanë dhe ato që po ndërtohen tash a e respektojnë planin urbanistik, hapësirat plotësuese siç janë hapësirat me gjelbërim, këndet për lojëra të fëmijëve dhe hapësirat tjera të parapara me planin urbanistik.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit -pyeti lidhur me rrugën “Bekim Berisha -Abeja” në të cilën është prerë asfalti dhe gjendja në të është mjaft e rënd dhe tanë askush nuk ndërmerr asgjë.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit -pyeti se çfarë është duke ndodhur me projektin e ndërtimit të palestrës sportive në fshatin Samadrexhë ku një pjesë e këtij projekti është dashur të përfundoj gjatë vitit 2015 kurse pjesa tjetër gjatë vitit 2016 kurse ky projekt nuk ka filluar akoma.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-paraqit përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit duke shtuar se klubit të futbollit “Vushtria” i kanë shkuar punët keq sidomos këto dy vitet e fundit pasi ka falimentuar fabrika e Llamkosit e cila ishte financuese e këtij klubit. Të shtoi se menaxheri i këtij klubit thonë se ka dhënë dorëheqje dhe komuna ka kërkuar me shkrin që të informohet me gjendjen e klubit. Pastaj njoftoi se ka pasur një takim me lojtaret dhe stafin e mbetur menaxhues të këtij klubit ku i ka inkurajuar që të vazhdojnë të punojnë për klubin përfaktin se ndihma e komunës brenda të drejtës dhe mundësisë nuk do të mungojë. Mandje ceku se në këtë klub ekziston një këshill drejtues i cili mund të thirr kuvendin e ri për zgjedhjen e strukturave drejtuese të klubit.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së-lidhur me thirrjen e kuvendit të ri të klubit të futbollit “Vushtria” njoftoi se i kishin ftuar në një takim themeluesit e klubit dhe lojtaret. Nga ky takim drejtoria ka kërkuar nga ata statutin dhe rregulloren dhe tanë do të vazhdojnë procedurat për

zgjedhjen e strukturave të reja të klubit. Pastaj ajo njofto se kryetari i komunës do të vazhdoj ta ndihmojë këtë klub. Lidhur me çështjen e ndërtimit të palestrës në fshatin Samdrexhë tha se vazhdimesh kemi kërkuar informatë nga ministria gjegjëse mirëpo si duket Ministria e Kulturës ka probleme me procedurat e prokurimit dhe projektet nuk po ecin sipas dinamikës së paraparë. Në fund ajo tha se do të bëjnë përpjekje që ky projekt të filloj sa më parë që të jetë e mundur.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-vazhdoi duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit duke theksuar se komisioni për emërtimin e rrugëve duhet të paguhet për punën e tij dhe për këtë do të shikohen mundësit. Kurse lidhur me rrugën "Bekim Berisha" do të bëhen analizat e duhur me Drejtoren e Shërbimeve Publike dhe do të ndërmerren veprimet e duhura.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se lidhur me ofrimin e ndihmës ndaj klubit "Vushtrria" qasja duhet të jetë e shpejtë dhe serioze si dhe duhet të sillemi me përgjegjësi e jo gjithë tjerët kanë kontribuar shumë që ai të ngritët dhe tani është momenti që të veprojmë shpejt që ky klub të paktën të mbetet në ligen e parë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –duke ju referuar ligjit për vetëqeverisje lokale propozoi që të votohet për shhangje nga rregullorja e punës së kuvendit duke e futur një pikë shtesë të rendit të ditë propozim-vendimin për ofrimin e ndihmës financiare klubit të futbollit "Vushtrria". Tute ai arsyetoj se kjo pikë e rendit të ditës që po kërkohet të votohet është e natyrës urgjente dhe ligji për vetëqeverisje lokale e lejon një gjë të tillë. Në fund propozoi që klubit të futbollit "Vushtrria" ti ndahen mjete financiare në vlerë prej 4.000 € për zhvillimin e aktiviteteve të tij.

Në vazhdim kuvendi me 22 vota "për" të tjerat abstenim vendosi që të shmanget nga Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe e futi në rend dite Propozim-Vendimin për ofrimin e ndihmës financiare klubit të futbollit "Vushtrria".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 23 vota "për", tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:


1. Me këtë vendim klubit të futbollit FC-Vushtrria i ndahen mjete financiare në vlerë prej katër mijë euro (4.000 €), për zhvillimin e aktiviteteve të tij.

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendim ndahen nga fondi për transfere dhe subvencione nga pozicioni stimulimi për sukseset e klubeve.

3. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit

